



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Tatjana Nurçe, Lorenc Luka, Robert Bitri, Edmond Leka, Vullnet Sinaj, Agron Shehaj dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Rovena Beqiraj – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Alda Klosi – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre – Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Julinda Bare – specialiste në sektorin e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zhvillimit Rural

Nikolin Lera – Drejtor i Politikave Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Thanas Andoni – Drejtor i Tarifës dhe Origjinës në Dogana

Amarildo Dervishi – specialist pranë sektorit të Tarifës dhe Originës në Dogana

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën. Së pari, më vjen mirë që komisioni është pothuajse plot me anëtarë nga të gjitha grupet parlamentare dhe, meqenëse me një pjesë të anëtarëve të komisionit është hera e parë që takohemi, uroj që të kemi një vazhdimësi konstruktive në dobi të procesit ligjvënës apo të kontrollit të zbatimit të ligjeve që miraton parlamenti ku ne shërbejmë.

Sot kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”. Relator është zoti Andrea Marto.

Për një prezantim të shkurtër të projektligjit fjalën do t’ia kaloj relatorit, më pas do t’ia kaloj fjalën zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë dhe më pas do të kemi pyetje dhe diskutime.

Nëse do ta shterojmë sot diskutimin dhe votimin e projektligjit, atëherë mund të paraqesim raportin për miratim në seancën e radhës, por nuk e kemi me ngut.

Në komision kanë ardhur disa opinione të dërguara me shkrim, me të cilat unë tani po njihem, nga një shoqatë që ka kërkuar dëgjuesë, nëse do ta çmonim ne të arsyeshme. Në vazhdim të diskutimeve do të gjykojmë se deri ku do të shkojmë me seancën sot, pra nëse do ta shterojmë apo do t’u japim kohë diskutimeve dhe dëgjësive të tjera.

Fjala për relatorin Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i qartë i rolit dhe i përgjegjësive të ministrisë përgjegjëse për Financat në lidhje me vlerësimin, miratimin e projekteve të koncesionit dhe partneritetit publik privat, si dhe ecurinë e kontratave të tyre nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzime buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Ndryshimet kryesore që sjell projektligji janë: heqja e mundësisë së zhvillimit të projekteve të koncesionit / partneritetit publik privat, në formën e propozimeve të pakërkuara nga sektori privat për një sërë sektorësh, duke e lënë në fuqi vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte e aeroporte, për prodhimin e shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.

Referuar rekomandimeve të ndryshme financiare ndërkombëtare, si FMN-së, Bankës Botërore dhe SIGMA – OECD-së, projekti përcakton shprehimisht që pas datës 1 korrik 2019 nuk do të jetë më e mundur që të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni ose

partneriteti publik privat në formën e propozimit të pakërkuar për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë.

Së dyti, shfuqizimin e sistemit të shpërblimit me pikë bonus, për propozime të pakërkua, për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte e aeroporte, për prodhimin e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror. Në vend të këtij sistemi, tani do të operohet me një mekanizëm kompensimi financiar për shpenzimet e bëra nga propozuesit për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, vetëm nëse propozuesi i pakërkuar nuk është ofertuesi fitues. Kjo shumë kompensimi për propozimin e kërkuar nuk mund të jetë më e lartë se 1% e vlerës së investimit.

Së treti, Ministrisë së Financave i përcaktohen kompetenca të reja, si: vlerëson dhe miraton të gjitha projektet e koncesionit ose të partneritetit publik privat, nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik e të tjera.

Kontratat e koncesionit ose të partneritetit publik privat, në mbështetje financiare, që marrin përsipër risqe fiskale, mund të dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave pas nënshkrimit nga palët, vetëm pas marrjes së vlerësimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për financat.

Ministri përgjegjës për financat përgatit një raport vjetor të përmbledhur për ecurinë e kontratave aktive të koncesioneve ose partneritetit publik privat, si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit.

Së katërti, një risi e rëndësishme e projektligjit është përcaktimi nga organi kolegjial, i cili është komiteti përzgjedhës i projekteve të koncesionit të partneritetit publik privat. Ky komision do të përfshihet në përzgjedhjen e projekteve të koncesionit ose partneritetit publik privat, të cilat do të mbështeten me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose në kryerjen e oponencës së tyre.

Komisioni drejtohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe anëtarë të këtij komisioni do të jenë: ministri përgjegjës për çështjet financiare, ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës, ministri përgjegjës për çështjen e energjisë dhe industrisë, ministri përgjegjës për çështjen e zhvillimit urban dhe ministri përgjegjës për mjedisin.

Pra, siç e shikojmë nga propozimi, këtu kemi të bëjmë me një komision të përbërë nga 5 anëtarë, pra nga 5 ministra. Por me strukturën e re të qeverisë, meqenëse një ministri mbulon dy – tri fusha, kemi vetëm 3 anëtarë dhe për këtë do të kërkohet një shpjegim.

Kompetencat e këtij komiteti lidhen kryesisht me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave të autoriteteve kontraktore, për mbështetjen me ekspertizë të specializuar për

hartimin dhe studimin e fizibilitetit për projektet e mundshme të koncesionit ose partneritetit publik privat.

Së pesti, projektligji parashikon një dispozitë të re, sipas së cilës tarifa e koncesioneve përbën titull ekzekutiv. Konkretisht, kur tarifa koncesionare nuk paguhet sipas ligjit, autoriteti kontraktues njofton ministrin përgjegjës për financat, urdhri i të cilit, për arkëtimin e tarifës, përbën titull ekzekutiv për bankat e nivelit të dytë ku ndodhet llogaria bankare e shoqërisë koncesionare dhe vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor.

Së gjashti, njësia e trajtimit të koncesioneve dhe partneriteteve publike private do të njihet si Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve. E tillë ka qenë edhe në legjislacionin përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 125 të vitit 2013.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve do të shërbejë si sekretari teknike për komitetin e përzgjedhjes së projekteve të koncesioneve dhe partneritetit publik privat.

Ndryshimet e mësipërme do të përmirësojnë dhe do të ndikojnë në përgatitjen me cilësi të studimit të fizibilitetit, i cili përbën thelbin e rezultateve dhe suksesit të një projekti, koncesioni ose partneritetit publik privat. Ndryshimet do të eliminojnë çdo implikim të paparashikuar në buxhetin e shtetit, si rrjedhojë e angazhimeve financiare të pakontrolluara nga ana e autoriteteve kontraktuese. Do të monitorohen risqet financiare nga ana e ministrisë përgjegjëse për financat dhe do t'u krijojë mundësi autoriteteve kontraktore që të kërkojnë mbështetje për zhvillimin e projekteve me ekspertizë të specializuar.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Marto!

Zëvendësministrja do të na bëjë një prezantim të shkurtër dhe pastaj fillojmë me pyetje e diskutime.

Fjala për ju.

Albana Shkurta – Përsëritje të gjithëve!

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar” është një iniciativë ligjore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila ka në fushën e përgjegjësisë orientimin dhe harmonizimin e veprimtarisë për zhvillimin e koncesioneve dhe partneritetit publik privat, por njëkohësisht edhe hartimin e politikave për miradministrimin e buxhetit.

Synimi i projektaktit është të përmirësojë kuadrin ligjor, mënyrën e zbatimit të procedurave për dhënien e koncesioneve dhe partneritetit publik privat, gjithashtu, të rrisë kontrollin për angazhimet fiskale të marra përsipër nga autoritetet kontraktore nëpërmjet

kontratave të koncesionit apo partneritetit publik privat, me qëllim minimizimin e impaktit fiskal në buxhetin e shtetit.

Në hartimin e këtij projektakti janë marrë në konsideratë edhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, si: FMN-ja, Banka Botërore dhe SIGMA – OECD-së, të cilat kanë raportuar dhe monitoruar legjislacionin dhe procedurat e dhënies së koncesioneve dhe partneritetit publik privat në vendin tonë.

Këto ndryshime vijnë në koherencë dhe harmoni të plotë me ndryshimet e bëra në ligjin organik për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar së fundmi, i cili konkretisht përcakton se Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat, si dhe çdo ndryshim të tyre nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontratat koncesionare apo partneritetit publik privat, si rregull, nuk duhet ta tejkalojnë kufirin prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar gjatë dy vjetëve të ardhshëm buxhetor. Kuvendi, në ligjin vjetor të buxhetit, miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të produktit të brendshëm bruto për të gjitha projektet koncesionare apo ato me partneritetit publik privat ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtas gjatë vitit buxhetor korrekt.

Disa nga risitë kryesore të këtij projekti janë heqja e propozimeve të pakërkuara në një sërë sektorësh referuar rekomandimeve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, SIGMA-OECD, sipas propozimeve të tyre, kufizimin e të drejtës së identifikimit dhe zhvillimit të propozimeve të projekteve të koncesionit nëpërmjet propozimeve të pakërkuara nga sektori privat, duke qenë se identifikimi i projekteve të koncesionit apo partneritetit publik privat lidhet ngushtësisht me interesin publik. Tashmë, duke qenë se Shqipëria ka krijuar një eksperiencë në fushën e koncesioneve që nga viti 2004, duke përfutur edhe nga ekspertiza e sjellë nga sektori privat në zhvillimin e studimeve të fizibilitetit për këto projekte të zhvilluara deri tani, por edhe nga partnerë ndërkombëtarë, është momenti i zhvillimit të këtyre projekteve nga vetë sektori publik, duke kufizuar kështu mundësinë e propozimeve të pakërkuara vetëm në disa sektorë strategjikë.

Në fakt, kjo është edhe tendenca e shteteve të tjera europiane. Këtu vlen për t'u theksuar se në çdo rast, edhe në rastin e identifikimit të projekteve të koncesionit apo PPP-të nga sektori privat, në formën e propozimeve të pakërkua nuk ka munguar transparenca e plotë mbi procedurat e dhënies, të cilat janë zhvilluar përmes procedurave konkurruese të publikuara në portalin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Konkretisht, me anë të këtij projektligji është propozuar që nga data 1 korrik 2019 të lejohen propozimet e pakërkua vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror. Duke qenë se sektori i energjisë, portet dhe aeroportet mbeten sektorë strategjikë është lejuar mundësia e propozimit të projekteve të koncesionit apo partneritetit publik provat nga sektori privat nëpërmjet propozimeve të pakërkua, por duke përjashtuar në këtë rast përfitimin e pikëve bonus për propozuesit e pakërkua.

Gjithashtu, ky projektligj përcakton shprehimisht që pas datës 1 korrik 2019 nuk do të jetë më e mundur të propozohen nga sektori privat projekte koncesioni apo partneritetit publik privat në formën e propozimit të pakërkua për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale me rëndësi të veçantë. Pas datës së sipërcituar këto projekte do të zhvillohen sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 125/2013 dhe jo me procedurë të veçantë, siç trajtohen aktualisht. Ky ndryshim vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Europian dhe direktivën 2014/23 të Komisionit Europian për dhënien e kontratave të koncesionit.

Elementi tjetër që sjell ky projektligj është heqja e bonusit për propozimet e pakërkua. Me qëllim rritjen e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët në procedurën konkurruese, është hequr mekanizmi i shpërblimit me pikë bonus të operatorëve që paraqesin propozimin e pakërkua, për sektorët ku kjo ende do të vazhdojë të lejohet. Pra, me anë të këtij projektligji, pas datës 1 korrik do të hiqet sistemi i shpërblimit të propozuesve të pakërkua me pikë bonus. Ndërkohë, për të nxitur sektorin privat për të propozuar projekte të studiuara duke përdorur kapacitetet dhe eksperiencën e tyre, është propozuar zëvendësimi i sistemit me pikë bonus me atë të kompensimit me vlerë monetare të propozuesit të pakërkua në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues. Në çdo rast vlera e kompensimit nuk mund të jetë më e lartë se 1% e vlerës së investimit. Mekanizmi i propozuar i kompensimit nuk e cenon konkurrencën dhe nuk krijon një avantazh për propozuesin e pakërkua.

Elementi tjetër është forcimi i rolit të Ministrisë përgjegjëse për Financat. Qëllimi i këtij projektakti është përcaktimi i qartë i rolit dhe përgjegjësi të Ministrisë përgjegjëse për Financat për vlerësimin, miratimin e të gjitha projekteve të koncesionit apo partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Duke qenë se projekt e koncesionit apo Partneritetit Publik Privat janë projekte komplekse afatgjatë, që implikojnë një sërë risqesh, si edhe detyrimesh kontingjente të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, është e nevojshme dhe e domosdoshme që të gjitha këto projekte, si ato me mbështetje financiare, apo edhe ato që nuk kërkojnë domosdoshmërisht mbështetje financiare, të paraqiten paraprakisht në Ministrinë përgjegjëse për Financat për vlerësim dhe miratim në këndvështrimin e implikimeve fiskale dhe buxhetore.

Një parashikim tjetër që vlerësohet, shumë i rëndësishëm, është se para nënshkrimit të kontratës përfundimtare të koncesionit apo partneritetit publik privat, kjo kontratë të paraqitet sërish për vlerësim pranë Ministrisë përgjegjëse për Financat, me qëllim verifikimin nëse autoritetet kontraktuese pas negocimit të saj i janë përmbajtur vlerësimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga Ministria përgjegjëse për Financat gjatë fazave të mëparshme të procesit.

Për të eliminuar çdo implikim të paparashikuar të buxhetit të shtetit, si rrjedhojë e angazhimeve financiare të pakontrolluara nga ana e autoriteteve kontraktuese, me qëllim që Ministria përgjegjëse për Financat të jetë në dijeni të të gjithë ecurisë së projekteve dhe kontratave të koncesionit apo partneritetit publik privat, është i domosdosëm parashikimi në ligj i dispozitave për monitorimin e performancës së tyre. Në rastin e performimit të dobët të kontratave është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme për minimizimin e kostove fiskale. Ministria përgjegjëse për Financat duhet të jetë e informuar për risqet e kontratave koncesionare për të analizuar dhe minimizuar risqet e tyre fiskale dhe buxhetore.

Gjithashtu, për të shmangur çdo ndryshim dhe kosto shtesë, si rrjedhojë e vënies në zbatim të këtyre projekteve është e domosdoshme që çdo ndryshim, si gjatë fazës së përgatitjes së projekteve në fazën e studimit të fizibilitetit, por edhe pas nënshkrimit të kontratës, kur është lidhur kontrata e koncesionit apo partneritetit publik privat duhet të vlerësohet dhe të miratohet paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Financat.

Për kontratat që parashikojnë mbështetje financiare ose që marrin përsipër risqe fiskale, duke qenë se sjellin angazhime afatgjata dhe klasifikohen si burime të

konsiderueshme risku, që mund të ndikojnë në prodhimin kombëtar bruto të një vendi, është e nevojshme që kontratat dhe çdo ndryshim i tyre të kalojë një sërë filtrash si nga vlerësimi dhe miratimi i Ministrisë përgjegjëse për Financat nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale, deri te miratimi përfundimtar i tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

Elementi tjetër është krijimi i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit apo partneritetit publik privat. Me qëllim rritjen e cilësisë së studimeve të fizibilitetit për këto projekte, në projektligj është parashikuar krijimi i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit, partneritetit publik privat, i cili do të jetë një organ kolegjal me objekt kryesor të veprimtarisë për zgjedhjen e projekteve, të cilët do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve të fizibilitetit dhe/ose oponencën e tyre.

Duke marrë shkas që me të këtij projektligji janë kufizuar mundësitë e zhvillimit të projekteve të koncesionit apo partneritetit publik privat nga sektori privat, pra është kufizuar ekspertiza që vjen nga sektori privat, do të mundësohet që për projekte të veçanta, autoritetet publike të asistohen me ekspertizë të specializuar për të hartuar studimet apo për të bërë oponencë më cilësore.

Pikërisht ndryshimi i kuadrit institucional, i parashikuar në këtë projektligj, do të sjellë përgatitjen me cilësi të studimit të fizibilitetit, i cili përbën thelbin e rezultateve dhe suksesit të një projekti të tillë, sikurse edhe mbështetjen me ekspertizë të specializuar për t'u bërë oponencë propozimeve të pakërkua në sektorët ku do të lejohet paraqitja e propozimeve të pakërkua.

Niko Peleshi – Mbaruat?

Albana Shkurta – Po.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka pyetje?

Po, zonja Ulqinaku.

Izmira Ulqinaku – Unë kisha në pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave.

Realisht e kam lexuar projektligjin, por do të doja të bënim një diskutim më konkret.

Pyetja ime është: ai i vlerësoni koncesionet e dhëna deri tani nga qeveria “Rama”, si dhe do të më interesonte nga ju një vlerësim, gjithashtu, për koncesionet e fundit që janë dhënë, për shembull, për koncesionin e llixhave në Dibër apo për koncesionin e pompave të karburanteve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në xhepin e qytetarëve. Koncesioni i dytë, i

pompave të karburanteve ndikon drejtpërdrejt dhe do të doja një vlerësim nga ju. Më pas do të bëj komentin.

Niko Peleshi – Zoti Panariti.

Edmond Panariti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në rendin e ditës të komisionit nuk po shikoj të jetë marrja në shqyrtim e propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim për çështjen e koncesioneve ose nuk ju është dhënë mundësia propozuesve të këtyre ndryshimeve të bëjnë mbrojtjen e këtij propozimi. Do të ishte mirë që këto dy propozime të ishin përbri njëri-tjetrit: propozimi i qeverisë për amendime dhe propozimi i opozitës, posaçërisht Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, për ligjin për koncesionet. Kjo do të ishte më e racionale. Propozimi i Lëvizjes Socialiste për Integrim nuk është në tryezë dhe me sa di unë, propozuesve nuk u është dhënë mundësia, siç i jepet qeverisë, për të bërë mbrojtjen dhe argumentimin e propozimeve.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Meqenëse problemi ka lidhje me m'u drejtua mua personalisht, në dijeninë time ky komision e ka shqyrtuar propozimin pak kohë më parë.

Edmond Panariti – Nuk ka pasur përfaqësues nga Lëvizja Socialiste për Integrim për të bërë mbrojtjen dhe paraqitjen e propozimeve përkatëse.

Niko Peleshi – Zoti Panariti, unë do të informohem tani për raportin, për të parë si është shqyrtuar ky propozim në komision, ku është vendosur edhe mosmarrja në konsideratë. Atë kohë nuk e kam drejtuar unë komisionin, ndaj duhet të njihem me raportin.

Vazhdojmë me pyetjet e tjera.

Po, zoti Luka.

Lorenc Luka – Pas një propagande, e cila ishte përtej logjikës të Kryeministrit dhe të ministrit që ju përfaqësoni, sot kemi për diskutim një projektligj sipas të cilit ato “suksese” që propagandonte qeveria, Kryeministri dhe ministri i linjës rezultojnë jo të drejta. Këtë e thonë ju vetë me ndryshimin që keni sjellë.

Kjo do të thotë që ju po sillni sot një projektligj që të mos jepen më koncesione për rrugë, do të thotë se i gjithë ai sukses për ato rrugë që u miratuan është zero. Pra, ju po riparoni diçka të gabuar, që e keni bërë prej disa vitesh, të denoncuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe opozita. Me çfarë justifikimi e paraqitni sot këtë projektligj me një ndryshim, që është shumë i rëndësishëm nëse analizohet në të gjithë aktivitetin e deritanishëm? A mos ministri i kaluar shkeli ligjin apo bëri veprime të papërgjegjshme?

Duhet të ketë një interpretim pse ky projektligj paraqitet sot për t'u ndryshuar dhe për t'u hequr PPP-të për rrugët.

Njëkohësisht, besoj se ju keni pasur veshë për të dëgjuar, Fondi Monetar, Banka Botërore dhe opozita kanë kërkuar prej disa vitesh që të ndaloheshin këto koncesione, sepse në mënyrë kriminale po rritej borxhi publik, të cilin ju gjithmonë keni tentuar ta fshihni nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm. Cili ka qenë efekti në rritjen e borxhit publik nga këto partneritete private të qeverisë suaj?

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Ju lutem përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të japin përgjigjet sipas radhës

Albana Shkurta – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së zonjës deputete për dy projektet, në dijeninë tonë koncesioni për llixhat nuk është dhënë, kurse për sa i përket projektit për pompat, nuk është parashikuar tarifë shtesë. Megjithatë, që t'iu përgjigjem pyetjes suaj, unë do të doja të fokusoheshim tek ato ndryshime apo përmirësime të projektligjit që ne kemi sjellë në këtë komision. Kështu që, unë dua ta orientoj bisedën sot për atë pjesë që jam përgatitur dhe që ka të bëjë me këto përmirësime që ne duam të sjellim në projektligj.

Në rast se do të ketë nevojë për informacion shtesë, mund t'i adresojmë këto edhe në një moment të dytë ose me shkrim. Kjo duke pasur parasysh që informacionin në pika të detajuara për çdo pyetje që mund të ketë mund të mos e kem këtu.

Për sa i përket pyetjes për propozimin e ardhur nga LSI-ja për këtë projektligj, në fakt, janë marrë parasysh propozimet e paraqitura në atë projektligj dhe mendojmë se janë adresuar në këto ndryshime që ne kemi prezantuar.

Për sa i përket pyetjes pse bëhet tani ky ndryshim, faktikisht, puna për përgatitjen e këtij projektligji ose ndryshime që janë paraqitur në këtë projektligj ka kohë që ka filluar. Gjatë kësaj kohe ka qenë në diskutime, duke marrë parasysh të gjithë procesin dhe të gjithë rrugën që duhet të kalojë një projektligj derisa të paraqitet në komision, gjë që është bërë gjatë vitit të kaluar.

Në hartimin e këtij projektligji janë marrë parasysh të gjitha rekomandimet e dhëna nga raportet që ne kemi marrë apo sugjerimet e dhëna nga institucione ndërkombëtare bazuar mbi përvojat më të mira botërore, por, gjithashtu, edhe nga rekomandimet e marra nga ambienti brenda vendit dhe nga faktorë të ndryshëm që kanë ngritur shqetësime për këtë çështje.

Mendojmë se paraqitja e këtij projektligji i adreson ato shqetësime që mund t'i kishin hapur rrugë problemeve në këtë aspekt. Deri tani mund të themi se ky legjislacion sjell një përmirësim të dukshëm dhe një adresim të disa nga çështjeve që ne mendojmë që nuk do të ketë arsye për të pasur një shqetësim për sa i përket këtyre projekteve.

Për sa i përket pyetjes për faktin që nuk do të ketë më projekte partnerit publik-privat për rrugët, jo se parashikohet që këto projekte nuk do të ofrohen më ose të rregullohen nëpërmjet këtij kuadri ligjor, por bëhet fjalë që eliminohet marrja e iniciativës nga një privat nëpërmjet një propozimi të pakërkuar. Pra, ky është elementi që nuk ka më një opsion të tillë për t'u organizuar ky lloj partneriteti publik-privat nëpërmjet një oferte të pakërkuar. Kjo është rezervuar vetëm në një listë shumë të vogël të veprimtarive ose sektorëve tek të cilët mendohet që nuk është krijuar ose nuk ekziston në atë lloj forme që ne do të donim ekspertiza për sa i përket vlerësimit të këtyre projekteve.

Për sa i përket efektit në borxhin publik, ju duhet të jeni në dijeni edhe me ndryshimin në ligjin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ligjin nr. 57/2016, për sa u përket kufizimeve për këto lloj projektesh në kuadrin e buxhetit, sipas të dhënave që ne kemi, vlera totale e këtyre lloj kontratave, që janë aktualisht aktive, është parashikuar që për vitin 2019 do të jetë 3% e nivelit të totalit të të ardhurave, ndërkohë që në totalin e vet është 46%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ka një pyetje ose diskutim nga zonja Gjermani, pastaj nga zoti Shehaj.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Unë kam dy-tre pyetje të vogla, në fakt.

Duke qenë se projektligji ka goxha ndryshime, ndoshta edhe teknike, për ta bërë sa më të thjeshtë, dua të di gjykimin ose vlerësimin tuaj lidhur me ndikimin që do të kenë këto ndryshime në aplikimin më tej të këtyre procedurave të partneritetit publik-privat: si do të lehtësohen ose jo këto procedura? Si do të monitorohen këto procese? Si do të ndikojë fakti që studimi i fizibilitetit tashmë do të jetë me ekspertizë më të lartë? Si do të ndikojë në cilësinë e projekteve që do të realizohen me partneritetin publik-privat?

Ndërkohë, në relacion është shkruar: “krijimi i organit kolegjal/Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit”. Ndoshta ne do t'i shohim kur të vijmë te diskutimi nën për nen, por meqenëse e kam mundësinë tani ta bëj si pyetje, aty janë disa

ministri përgjegjëse. Në fakt, e tha edhe relatori, zoti Marto, ndoshta do të na e shpjegoni pak më shumë ju, duke qenë se janë pesë të shkruara në projektligj, ndërkohë që ne kemi ministri që mbulojnë më shumë fusha, a do të ndikojë kjo ose jo në punën e komitetit të përzgjedhjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Shehaj, e doni fjalën për pyetje apo diskutim?

Agron Shehaj – Kam pyetje.

Niko Peleshi – Të përgatitet zoti Marto.

Agron Shehaj – Faleminderit!

Pavarësisht faktit që unë jam i mendimit se ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” duhet anuluar tërësisht, sepse ndryshimet e propozuara janë thjesht një shfaqje për t’u dukur sikur ju gjoja po bëni diçka kundër, tani e kanë marrë vesh të gjithë që këto janë thjesht një instrument për të vjedhur, dua mendimin tuaj për sa u takon kompanive *off shore*, duke pasur parasysh edhe se çfarë ndodhi, besoj se jeni në dijeni për skandalin e kompanisë *off shore*, së cilës ishit duke i dhënë 30 milionë euro, 12 milionë nëpërmjet OST-së dhe 18 milionë të tjerë nëpërmjet ARRSH-së. Pra, dua mendimin tuaj për sa i takon përjashtimit të këtyre kompanive nga pjesëmarrja në koncesione. Çfarë mendoni ju për këtë? A nuk do të ishte e arsyeshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Marto.

Agron Shehaj – Kam edhe një pyetje tjetër, në fakt.

Për sa i takon afatit, në ligj keni caktuar që këto ndryshime do të hyjnë në fuqi nga data 1 korrik. Pyetja është: a keni ndër mend që të jepni koncesione të tjera para datës 1 korrik, prandaj është vendosur kjo datë, pra hyrja në fuqi nuk bëhet menjëherë?

Pyetja e tretë, mos ky afat ka të bëjë me koncesionin Orikum-Dukat, një koncesion prej 70 milionë eurosh, për një rrugë jo më të gjatë se 16 kilometra, që nuk është absolutisht një prioritet? Ky është një koncesion, është një vjedhje për shqiptarët, sidomos për vlonjatët, duke pasur parasysh të gjitha prioritetet e tjera dhe nevojat që ka qyteti i Vlorës: 70 milionë euro për 16 kilometra! A është kjo arsyeja pse është shtyrë afati në datën 1 korrik?

Niko Peleshi – Fjalën e kanë zoti Marto, zoti Suli dhe pastaj zoti Panariti.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë se historia e koncesioneve nuk ka nisur në shtator të vitit 2013, unë do t’u kërkoj përfaqësuesve të ministrisë që të na japin një statistikë se sa kanë qenë koncesionet, në numër dhe në vlerë, para shtatorit të vitit 2013, dhe sa kanë qenë në periudhën shtator 2013 –

deri në vitin 2019. Në qoftë se nuk i keni sot shifrat, mund t'ia dërgoni në një kohë të dytë komisionit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Nëse më lejohet, që të mos bëj një pyetje të re, po bëj një shtesë te pyetja e zotit Marto: formula e propozimit të pakërkuar është shpikur në qeverinë e tanishme, pas vitit 2013, apo ka ekzistuar edhe para vitit 2013?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Suli dhe pastaj zoti Panariti.

Rakip Suli – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fiks.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti kryetar, se ndoshta gabohem, por nga një pjesë e kolegëve nuk është kuptuar as koncepti. Flasim për projektligjin dhe ndryshimet që vijnë sot.

E dyta, e kapi shumë mirë edhe kolegu, koncesionet nuk kanë filluar sot dhe janë miratuar, siç e dëgjova edhe zëvendësministren, që në vitin 2004, kur ka filluar edhe miratimi i ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë hedhur themelet dhe është marrë nisma e hapjes së autostradës për koncesionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dua të bëj një pyetje konkrete.

Meqenëse kolegët përballë të opozitës e mbajnë veten si shenjtorë, ndërkohë që ne këtej jemi djalli, dua të bëj një pyetje të drejtpërdrejtë: çfarë impakti po jep konkretisht koncesioni që është dhënë për Rrugën e Arbrit? Si po ecin punimet atje, sepse në kohën e Partisë Demokratike diskutohej, madje zoti Mima e di shumë mirë, mendohej të jepej me 500 milionë dollarë me koncesion?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj, ju lutem!

Sot është me 250 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është realisht diçka konkrete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta mbaroj, se nuk kam asgjë me ty!

Konkretisht pyes: si po ecin punimet në këtë rrugë, që do të thosha se është një model shumë pozitiv për sa u përket koncesioneve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Është brenda rendit të ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëni pyetjen.

Rakip Suli – E dyta, deputetët e opozitës duhet të kuptojnë diçka shumë themelore.

Niko Peleshi – Ju lutem, jini konçizë.

Rakip Suli – Po, shumë shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo rrugë që po ndërtohet, konkretisht Rruga e Arbrit, kompanisë që të marrë paratë i takojnë dhjetë vjet, që sot e dhjetë vjet imagjinohet se sa është kostoja e asaj rruge, pa u nisur nga faktori se sa do të fitojë kjo zonë nga përfundimi i kësaj rruge, e cila përfundon në vitin 2021: impakt ekonomik e të tjerë, por nuk ka rëndësi.

Dua të di konkretisht: si është impakti dhe ecuria e punimeve të kësaj rruge, meqenëse është model për tre “p-të” që është bërë nga qeveria “Rama”.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Panariti.

Edmond Panariti – Kam një pyetje për zonjën zëvendësministre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shikoj këtu një nonsens dhe kërkoj që ju të më jepni një përgjigje shteruese, sepse, ndërkohë që ju propozoni heqjen e mundësisë së zhvillimit të projekteve me koncesion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...me një ofertues të pakërkuar për një grup investimesh, e lejoni atë për një grup tjetër investimesh. Ku është racionalja e këtij veprimi? Cilat janë argumentet dhe kundërgjigjet? Pse disa zgjidhen për të qenë përfitues edhe me oferta të pakërkua, ndërsa për të tjerët kërkohet të shpallet mekanizmi i garës? Ku qëndron kjo?

E dyta, fakti që ju anuloni kontratat e pakërkua me efekt prapaveprues nga data 1 korrik 2019, pyetja shtrohet: po për kontratat e mëparshme si do të veprojë? Do të kërkohet që këto të jenë të mirëqena? Pse ligjit nuk i jepet fuqi prapavepruese? Pra, të gjitha kontratat të trajtohen me këtë frymë, me frymën e propozimit që ju keni sjellë tashmë në kuadrin e një amendimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo do të ishte për të qenë parimorë, sepse diferencimi që bëhet për mua mban erë abuzivizmi. Megjithatë, kërkoj nga ju të më shpjegoni se cila është racionalja dhe cili është argumenti që ju paraqisni kur një grup e trajtoni me kontratë të pakërkuar, ndërsa një grup tjetër ia nënshtroni konkurrencës së lirë.

Edhe diçka tjetër, që ju e përmendët pak më parë, unë nuk i shikoj propozimet tona të reflektuara në projektligjin e paraqitur, ndryshe nuk do ta kisha ngritur shqetësimin që nuk iu dha mundësia Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, propozuesve të projektligjit, të paraqisnin dhe të jepnin argumentet përkatëse për ndryshime në ligjin e koncesioneve. Për sa kohë kjo gjë nuk ka ndodhur, unë e quaj ende të pakryer, të parealizuar këtë detyrim, do të thosha, procedural, ku, krahas qeverisë, ka të drejtë edhe opozita të paraqesë ndryshimet përkatëse. Kryetari më premtoi se do ta shikojë këtë çështje dhe do të më japë përgjigje. Por pyetja ishte specifike. Shpresoj që të më sqaroni: pse ju bëni diferencime në amendimin që keni paraqitur në projektligjin përkatës?

Niko Peleshi – Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, vazhdojmë me përgjigjet. Por, ju lutem, jini sa më konçize, në mënyrë që edhe ju, por vërejtja është edhe për anëtarët e komisionit, të qëndroni brenda rendit të ditës. Natyrisht, në qoftë se do të ketë kërkesa përtej rendit të ditës, është detyrimi juaj që ta informoni më pas me shkrim këtë komision, të gjithë anëtarët e tij apo anëtarin që ka ngritur pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Shkurta – Faleminderit!

Të filloj me pyetjet e zonjës Gjermani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishit ju përpara?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kujtoj.

Niko Peleshi – Nuk ka problem.

Albana Shkurta – Më duket se ishte zonja Gjermani përpara.

Megjithatë, nëse është okej për ju, mund t'i ndryshoj.

Niko Peleshi – Vazhdoni me përgjigjet, siç i keni strukturuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Je në rregull, nuk po shkel gjë.

Albana Shkurta – Atëherë, në lidhje me pyetjen e parë, në mënyrë pak më konçize, se cili është thelbi i ndryshimeve të propozuara, në radhë të parë, kufizimi i të drejtës për të identifikuar projekte koncesioni ose të partneritetit publik-privat nga sektori privat, nëpërmjet

propozimeve të pakërkua, nga një listë shumë e gjatë projektsh, që e ka origjinën në versionin e parë të këtij ligji të miratuar më 25 prill të vitit 2013, ku praktikisht lejoheshin propozimet e pakërkua për çdo lloj projekti, në këtë rast ne kemi sjellë këtu një propozim për ta kufizuar ndjeshëm llojin e projekteve, të cilat ende mund të lejohen.

Pastaj, në përgjigje të pyetjes së zotit Panariti, besoj se do ta shtjelloj më tej.

Element tjetër është rritja e transparencës dhe trajtimi i barabartë për të gjithë operatorët në procedurën konkurruese. Pra, edhe një herë, ka ose jo propozim të pakërkuar, procedura konkurruese ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë gjithmonë. Mënyra jonë për ta adresuar këtë disbalancë që krijohet është pikërisht elementi që sjell apo përmirësimi që sjell ky projektakt, që është heqja e pikëve bonus, të cilat, subjektit që sjell një propozim të pakërkuar, i japin deri diku një avantazh konkurrues në krahasim me të tjerët, sepse e fillon garën, si të thuash, nëse është një garë shpejtësie, disa metra para të tjerëve.

Për ta eliminuar këtë avantazh në dukje, ku, siç edhe është parë në shumicën e rasteve, që ata që kanë qenë propozues të pakërkuar, kanë rezultuar të jenë edhe fitues të projektit, pra pikërisht për ta eliminuar këtë disbalancë është futur koncepti i kompensimit për mundimin e tyre, për faktin se kanë vënë në dispozicion burime, kohë, para dhe eksperiencën që ato zotërojnë. Pikërisht për t'u dhënë atyre një trajtim *fair*, u thuhet: nuk do të vlerësoheni me pikë, por në rast se ju nuk shpallen fitues, për gjithë këtë mundim që keni marrë do të keni një kompensim në vlerë monetare, për të cilin, gjithashtu, është vënë një limit i sipërm, pra në asnjë rast nuk mund të jetë më shumë sesa 1% e vlerës së investimit.

Nisur nga praktika, mund të themi se në shumicën e rasteve projekte të kësaj natyre janë kaq komplekse dhe kërkojnë kaq shumë angazhim të burimeve jo vetëm nga brenda këtyre subjekteve, por edhe nëpërmjet konsulencës që ato marrin, saqë mund të arrijnë në vlera të konsiderueshme. Megjithatë, propozimi i paraqitur parashikon që kjo gjë të mbahet, gjithashtu, në kontroll, pra të mos ekzistojë mundësia që dikush që vjen me një propozim të pakërkuar, çfarëdo shpenzimi që ata të kenë bërë, ne të kemi detyrimin që t'ia kompensojmë. Ndërkohë, gara është e hapur për të gjithë ata që kanë interes të marrin pjesë në konkurrim.

Elementi tjetër është roli i përforcuar i Ministrisë përgjegjëse për Financat në çdo hap të procesit. Në rast se deri... Sipas ligjit aktual në fuqi ose kuadrit ligjor në fuqi, kemi një përmirësim që është përfshirë tashmë në ndryshimin që u bë në ligjin e buxhetit në vitin 2016, i është dhënë Ministrisë së Financave një instrument, një mënyrë për të pasur më tepër kontroll ndaj problematikave që mund të lindin nga kjo gjë. Nga ana tjetër, ndryshimi i propozuar në ligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” i jep pikërisht Ministrisë

së Financave dhe, njëkohësisht, autoriteteve kontraktore detyrimin për ta përfshirë në çdo moment Ministrinë përgjegjëse për Financat, me qëllim që jo vetëm në fazën e parë, kur propozohet një projekt apo kur një projekt është në fazën e vlerësimit, jo vetëm në fazën e gjyqimit, se cila është mënyra më e duhur për ta realizuar një projekt, por duke u bazuar në ligjin “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” apo nëpërmjet një ligji që bazohet në prokurimet publike, në të gjitha këto raste roli i Ministrisë së Financave është vazhdimisht rol vendimtar për të siguruar që balanca në fund të ditës për sa u përket detyrimeve që ka shteti, për sa u përket angazhimeve që kemi ndërmarrë për uljen e deficitit buxhetor dhe të gjitha aspekteve të tjera, të garantohet.

Për rastet kur ka pasur ndryshime gjatë fazave që kalon një projekt i tillë, nga momenti kur bëhet vlerësimi i projektit deri në momentin kur finalizohet kontrata, tashmë ky projektligj parashikon që Ministria përgjegjëse për Financat të ketë një vend, kur i thonë, në tavolinë, në çdo hap të këtij procesi, deri në momentin kur nënshkruhet kontrata, por edhe më tej nëpërmjet...

Agron Shehaj – Zoti kryetar, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Shkurta – ...instrumenteve për monitorimin.

Agron Shehaj – A ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni që ju ndërpres!

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Agron Shehaj – A ka mundësi që zonja t’u përgjigjet pyetjeve dhe të mos na mbajë një orë hartim dhe të arrijmë në fund?

Niko Peleshi – Pak më shkurt, zonja zëvendësministre.

Agron Shehaj – Të mos tallemi kot!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përgjigjen e kemi të shkruar ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ndikimi tani?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T’i lëmë këto lojëra koti! Ne bëmë pyetje serioze.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T’u përgjigjet pyetjeve dhe mbaron muhabeti!

Niko Peleshi – Më falni pak!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Shehaj – Çfarë janë këto llafë kot tani?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi kohë për të humbur kot.

Niko Peleshi – Nuk mund ta kondicionojmë përgjigjen me “po ose jo”.

Agron Shehaj – Le të përgjigjet shkurt.

Niko Peleshi – Dakord, sa më shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – ...pastaj do të kërkojë prapë fjalën ky dhe të thotë: ma sqaro pak më tepër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe ju përgjigjuni: “Po/Jo”.

Niko Peleshi – E vetmja gjë që mund të kërkojmë, është të jeni më sintetikë.

Albana Shkurta – Dakord.

Në lidhje me pyetjen e dytë të zonjës Gjermani, për sa i përket mënyrës se si është kompozuar Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve. Atëherë, duke pasur parasysh që po sjellim një projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” dhe, duke parë historikun e këtij ligji, normalisht nuk po sjellim disa ndryshime që i referohen këtij kuadri për sa i përket mënyrës se si është krijuar qeveria. Pikërisht, për këtë arsye, është parashikuar që ky komitet të mbulohet me 5 fusha përgjegjësie, ndonëse konfigurimi aktual i qeverisë (kjo u përmend edhe nga relatori), aktualisht e sjell këtë komitet në një format të përbërë prej 3 anëtarësh. Në çdo rast ky komitet i përbërë nga 3 ministra aktualisht përgjegjës për këto 5 fusha të veprimtarive, të cilat duhet të kenë patjetër *a seat at the table*. Normalisht, ministrat do të kenë mundësi të angazhojnë ekspertët, të cilët janë pjesë e strukturave sipas funksioneve dhe, gjithashtu, do të ketë mundësi për të angazhuar konsulencë nga jashtë, me qëllim për të plotësuar ato hapësira, kur ato mungojnë, në rastin e vlerësimit të projekteve, që mund të jenë shumë më komplekse.

Për sa u përket pyetjeve të zotit Marto...

Niko Peleshi – Më falni, zonja zëvendësministre, se ka një propozim për procedurë!

Urdhëroni, zoti Baraj!

Besnik Baraj – Meqë pyetjet janë të shumta dhe janë shumë komplekse, nëse ju bini dakord, a është e mundur që përfaqësuesit e ministrisë t’i përgatisin me shkrim dhe të na

i sjellin, në mënyrë që ju këtu të thoni fjalën tuaj që, me siguri publiku ka shumë interes për ta dëgjuar, sepse kemi kohë pa ju dëgjuar në komision? Nëse e japim dhe është më racionale.

Agron Shehaj – Për sa më takon mua, në asnjë mënyrë. Unë nuk bie pre e provokimeve të llojit, kemi apo nuk kemi shumë për të thënë. Unë nuk bie pre e këtyre budallallëqeve. Le ta dëgjojmë zëvendësministren!

Niko Peleshi - Ju lutem, ruani etikën!

Agron Shehaj - Të thuash se kemi shumë, apo nuk kemi shumë që mungojmë dhe nuk flasim, këto janë provokime.

Niko Peleshi – Ishte brenda etikës. Ju lutem, ruani etikën!

Agron Shehaj – Brenda etikës, por provokim ishte.

Niko Peleshi – Ju lutem, përfundoni përgjigjet shkurt!

Siç ju thashë nëse ka gjëra që nuk i keni me vete, mund t'ua dërgoni me shkrim anëtarëve të komisionit.

Ju lutem, sa më shkurt se do të fillojmë me diskutimet, që të mos e zgjasim shumë këtë seancë.

Albana Shkurta – Dakord. Në lidhje me pyetjen ose komentin, nëse ligji duhej shfuqizuar.

Agron Shehaj – Më falni!

Nëse keni nevojë, mund ta përsëris pyetjen. Nuk është koment, por është pyetje. Unë desha të di mendimin tuaj për sa i takon përjashtimit të kompanive *off shore* nga pjesëmarrja në garat për koncesionet, duke pasur parasysh se çfarë ndodhi herën e fundit, që u përfshi në garë një kompani *off shore* dhe nëpërmjet asaj kompanie u tentua jo vetëm vjedhja, por edhe pastrimi i parave në SHBA.

Niko Peleshi – Ju lutem, lëreni ta përfundojë përgjigjen!

Albana Shkurta – Për sa i përket kësaj, normalisht ka një procedurë dhe ka një kuadër rregullator që në çdo hap të një procesi të tillë, rregullon mënyrën se si përzgjidhen, seleksionohen dhe kriteret që duhet të plotësojë një kompani. Aktualisht, ajo është në fazën e vlerësimit apo të hetimit, se nuk mund të jem unë sot në gjendje të përgjigjem për këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Shehaj – Unë desha mendimin tuaj.

Albana Shkurta – Zbatimi i legjislacionit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agron Shehaj – Atëherë, kuadrin ligjor e bëjmë ne. Ju më thoni që ka një kuadër ligjor për atë punë. Atë e bëjmë ne.

Unë desha të di mendimin tuaj, si zëvendësministre e Financave. Çfarë mendoni ju për sa i takon përjashtimit të kompanive *off shore* nga pjesëmarrja në garat për koncesionet?

Albana Shkurta – Nuk kam ndonjë koment për këtë.

Agron Shehaj – Faleminderit!

Albana Shkurta – Për sa i përket afatit, përse është përmendur apo është sugjeruar data 1 korrik 2019. Normalisht, çdo përmirësim apo ndryshim i një ligji të caktuar, merr parasysh edhe një fazë tranzitore për sa u përket përgatitjeve që duhet të kryhen.

Gjithashtu, është hipotetike, sepse ne kemi ardhur sot këtu për ta kaluar këtë projektligj pranë këtij komisioni. Normalisht, nuk është në dorën tonë të dimë dhe të parashikojmë në çdo moment se sa kohë do të duhet deri në kalimin përfundimtar të këtyre ndryshimeve. Nëse është përcaktuar data 1 korrik 2019, sa më shpejt që të kalojnë të gjitha këto procese, ajo mund të futet në fuqi që në këtë datë.

Në rast se kjo mund të marrë më shumë kohë, nuk është çudi që kjo mund të jetë edhe në një datë tjetër, kështu kjo është një datë e përcaktuar aty për afatin që mund t'i duhet një ligji për të kaluar.

Agron Shehaj – Një sekondë, se dua të flas për këtë çështje!

Niko Peleshi – Pak më vonë do të fillojmë me diskutimet!

Agron Shehaj – Një sekondë, se më duket se zonja nuk e kuptoi pyetjen.

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Agron Shehaj – Edhe një herë...

Albana Shkurta – Unë e kuptova pyetjen dhe përgjigja është, se është parashikuar që në këtë datë...

Agron Shehaj – Edhe një herë. Unë ju pyeta, nëse keni ndër mend të jepni koncesione të tjera, ndërkohë para datës 1 korrik 2019? A është shtyrë afati në këtë datë, sepse keni ndër mend të mbyllni koncesionin për segmentin Orikum-Dukat, që ka një vlerë 70 milionë eurosh, ku oferta që ka fituar ka pasur një fond prej 99,96% të fondit limit? Këto ishin 2 pyetjet. A keni ndër mend të jepni koncesione të tjera dhe a do të vazhdojë ky koncesion ndërkohë?

Niko Peleshi – Përgjigja ishte e qartë, zoti Shehaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thashë se nuk është kjo arsyeja.

Arsyeja është koha që duhet për të...

Agron Shehaj – Një sekondë se ka ardhur zëvendësministrja për t'u përgjigjur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ajo e tha shumë qartë.

Albana Shkurta – A mundem?

Për sa kohë që kemi një kuadër ligjor në fuqi, çdo proces që ka nisur apo deri në fazat e tjera që do të vazhdojë, do të bazohet në këtë kuadër ligjor që kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, sa më shpejt të kryhen këto ndryshime, aq më mirë do të jetë për të gjithë të vijuar më tej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Të lutem, zoti Shehaj!

Mos e merrni fjalën sa herë të doni! Ju folët për provokime, ndërkohë që ju bëtë një pyetje shumë joetike dhe shumë provokuese. Ajo pyetje nuk mund të bëhej këtu. Gjithsesi, është e drejta juaj.

Agron Shehaj – Pyetjet që bëhen për paratë e qytetarëve, nuk janë provokative, sidomos në një vend kaq të varfër si ky.

Niko Peleshi – Nuk mund të akuzoni që vidhet. Kjo është një akuzë që nuk mund të hidhet kështu, në erë. Në qoftë se ke diçka konkrete, nuk është ky vendi. Shko, çojë atje ku duhet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Rakip!

Urdhëro, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Për procedurë.

Të nderuar kolegë, të paktën në komisionin tonë është krijuar prej shumë vitesh një traditë për një komunikim etik, civil, qytetar dhe me argumente. Mos ta prishim këtë traditë edhe për faktin se komisioni trajton çështje shumë profesionale dhe me etikë, edhe për faktin që unë nuk dua që ne ta prishim etikën dhe gjuhën e komunikimit, kur përballë kemi një zonjë zëvendësministre.

Do t'ju lutesha të kujtoni faktin që flasim me etikë, me profesionalizëm dhe me argumente. Ne ramë dakord që vërtet pyetjet që do t'i drejtohen zëvendësministres, do të marrin përgjigje, mund të na pëlqejë ose jo, por kemi të drejtë më pas t'i komentojmë dhe të japim mendimin tonë si deputetë dhe si përfaqësues të qytetarëve. Për pyetjet për të cilat zëvendësministrja mund të mos ketë informacion me vete, të na i sjellë me shkrim.

Nëse doni të bëjmë një mbledhje tjetër, ku ta diskutojmë ligjin nen për nen. Këtu kërkoj mirëkuptimin tuaj.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Panariti!

Më pas, përsëri zoti Shehaj.

Edmond Panariti – Zoti kryetar,

Unë mendoj se opinioni publik dhe ky komision, ndoshta dëshiron të informohet për kontratat koncesionare që janë dhënë deri tani, fituesit e këtyre kontratave me kapitalin e tyre bazë financiar, likuiditetet e tyre financiare, sa përqind të investimit përballojnë ato?

A mund të më jepni ju një përgjigje shteruese? Si do të mbulohet pjesa tjetër, duke përdorur garancinë sovranë që jep qeveria shqiptare, e cila e paguan në fakt koncesionarin. Më pas, me këtë garanci sovranë, koncesionari shkon dhe kërkon kredi në bankë, duke e transferuar rrezikun 100% te taksapaguesit, sepse në rast se ai në rast se nuk mobilizon kapitalin e tij bazë, sikurse unë kam dëgjuar nga disa vlerësime të pavarura të ekspertëve, atëherë ne futemi në një rrezik shumë të madh. Dëshiroj të mos jetë kjo, prandaj pyetja ime është specifike. Sa përqind të investimit të kontraktuar kompanitë fituese e realizojnë me kapitalin e tyre bazë financiar dhe sa përqind e realizojnë me kredi, me garanci sovranë të shtetit shqiptar?

Niko Peleshi – Dakord.

Keni pyetje, zoti Shehaj?

Nëse keni diskutim, ju lutem prisni ta mbyllim seancën e pyetjeve.

Agron Shehaj – Unë thjesht desha të them se zonja nuk iu përgjigj pyetjes sime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Desha të them se nuk mora përgjigje për pyetjen për koncesionin për segmentin Orikum-Dukat. Si është e mundur që zëvendësministrja të vijë këtu dhe të na thotë se ajo varet nga sa kohë do të na duhet ne të aprovojmë ligjin?

Ju jeni në maxhorancë këtu dhe i apromoni ligjet...

Niko Peleshi – Ajo ju tha, se deri sa të hyjë në fuqi ligji i ri, natyrisht, procedurat do të vazhdojnë me ligjin e vjetër...

Agron Shehaj – Me sa duket e kam kuptuar keq. Përgjigjja është po apo jo sa i takon këtij koncesioni...

Niko Peleshi – Nuk ju tha as se çfarë ka në plan sektori të propozojë.

Agron Shehaj - ... do të jepet apo nuk do të jepet?

Niko Peleshi – Të lutem, kjo nuk ka kuptim!

A ka pyetje të tjera?

Albana Shkurta – Mendoj se iu përgjigj pyetjes jo për projektet në mënyrë të përveçme...

Niko Peleshi – Zonja Zëvendësministri, ju lutem!

Albana Shkurta - ... por në parim iu përgjigja pyetjes. Ne nuk kemi ardhur këtu për të diskutuar çdo projekt në mënyrë të përveçme, por propozimet e një projektligji, prandaj do të doja shumë të fokusohemi këtu...

Agron Shehaj – Qytetarët duan të dinë nëse do të bëhet rruga me 70 milionë euro apo jo?

Niko Peleshi – Kjo është një pyetje që del edhe nga rendi...

Albana Shkurta – Të gjitha projektet që janë aktualisht në proces po ndiqen sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Agron Shehaj – Do të investohen 70 milionë euro për 16 kilometra të një rruge, të gjithë këtu mendoj se të paktën një herë kanë kaluar dhe e dinë shumë mirë që nuk është prioritet...

Niko Peleshi – Sapo kemi filluar diskutimin, sepse pyetjet mbaruan.

Vazhdoni zoti Shehaj, me diskutimin.

(Diskutime pa mikrofon)

E keni diskutim në formë pyetjeje?

Jo, në rregull.

Po, zoti Panariti.

Edmond Panariti – Zoti kryetar, unë bëra pyetje dhe nuk mora asnjë përgjigje. Në rast se është në gjendje për të më dhënë një përgjigje, të ma japë tani. Sa për qind të investimit realizojnë fituesit me kapitalin e tyre dhe sa me kredi?

Albana Shkurta – Gjatë fazës së përgatitjes për këtë projektligj, ndërkohë që ishim duke u përgatitur për pjesëmarrjen në këtë komision, kemi analizuar dhe parë një pasqyrë të të gjitha kontratave aktualisht aktive. Normalisht, çdo projekt është i ndryshëm nga tjetri sa i përket nivelit të investimit paraprak që kërkohet në përputhje me llojin, me sektorin dhe fushën e veprimtarisë. Nga kjo pikëpamje ne mund t'ju dërgojmë me shkrim një tabelë shteruese, e cila mund t'ju tregojë se sa për qind të investimit të vlerës totale të një kontrate zë investimi dhe mënyrën se si ajo është në përgjithësi për kontrata të veçanta apo për kontrata të...

Edmond Panariti – Një shifër paraprake nuk mund të na jepni?

Albana Shkurta – Jo, sepse të gjitha janë të ndryshme...

Edmond Panariti – Unë kam dëgjuar që as 2-3% të investimit nuk e realizojnë dot me kapitalin e tyre fillestar dhe pjesën tjetër duan ta marrin me bankë, me kredit, me garanci sovraane?

Niko Peleshi – A ka ndonjë përqindje se sa duhet të jetë garancia e projektit?

Në rast se nuk e keni këtë informacion, ju lutem, dërgojeni me shkrim!

Albana Shkurta – Për çështje kohe ndoshta është më mirë që këtë informacion t’ju dërgojmë me shkrim me disa tabela shumë të thjeshta për t’u lexuar.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi, ka pyetje.

Më pas e ka fjalën zoti Mima për diskutim.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Ju jeni e pranishme këtu sot për të bërë disa ndryshime në ligjin nr. 125, të vitit 2013. Do të doja të dija kur ky ligj ka filluar veprimtarinë e tij këto koncesionet që përmbledhen në kuadër të këtij ligji a kanë të qenë të regjistruara diku? A kemi pasur një regjistër të koncesioneve me fillimin e këtij ligji dhe nëse nuk e kemi pasur a e kemi sot?

Albana Shkurta – Që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, me formën që ka sot me disa amendime, amendimi i fundit është kryer në 2016-ën, normalisht është krijuar një regjistër, i cili ka një dispozicion të tij një ekip dhe një numër ekspertësh, të cilët garantojnë jo vetëm informacionin dhe transparencën totale në lidhje me të gjitha kontratat koncesionare aktive, por edhe sa i përket një instrumenti që na lejon monitorimin e performancës së tyre dhe ky është një informacion ky çdokush mund të aksesojë. Ky regjistër mirëmbahet nga ATRAKO dhe është i mundshëm për t’u aksesuar *online* nga kushdo që është i interesuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk ka pasur një regjistër të tillë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Mima, fjala për ju.

Florion Mima – Në qoftë se unë ju jap një kopje të fletëve të regjistrit, edhe dixhitale, të 2010-s, të 2011-s, të 2012-s, të 2013-s, a do t’i qëndronit përgjigjes që ju dhatë?

Me fjalë të tjera po ju jap edhe një gjysmë këshille, në pozicionin që jeni vërtet je në një post politik, por që të ecësh përpara duhet të ecësh me profesionalizëm dhe jo me politikë. Më vjen shumë keq që u përzier në muhabete dhe biseda politike këtu...

Sa i takon çështjes që jemi diskutuar po e nis me zonjën Gjermani, të kam respektuar gjithë jetën, të ndaj dhe të veçoj për cilësitë që ke, pavarësisht se jemi kundërshtar. Sot na kërkoje të ruajmë etikën në një kohë që janë në lojë miliarda euro të këtij populli. Unë do të të kërkoj falje edhe nëse e prishim etikën dhe ti të mos mërzhitesh fare, sepse pyetjet që ngritën dy kolegët, Andrea dhe Rakipi, janë për të shpërngulur vëmendjen, kështu që pa

filluar dua t'u jap një përgjigje të dyve për koncesionet e tjera që janë dhënë deri në vitin 2013. Edhe ato janë propozime të pakërkua, zoti kryetar, por asnjë qindarkë nuk ka dalë nga buxheti i shtetit. Privati ka kryer studimin, ka kryer investimin, i paguan shtetit të gjitha tatimet, i paguan *fee*-në koncesionare dhe pas 25 vjetësh vepra kalon në pronësi publike.

Sot, ne këtu jemi duke folur për PPP-të, të gjitha të garantuara me paratë e shqiptarëve dhe që do të paguhen me paratë e shqiptarëve. 2,2 deri në 2,5 herë më shtrenjtë është kostoja totale, përfshi interesat e kredive që do të merren nga privati, por që do të paguhen nga buxheti i shtetit. A jua kanë thënë vartësit këtë?

Kjo është edhe si përgjigje sa i takon pyetjes së zotit Panariti, 2,2 deri në 2,5 herë është llogaria në fund fare më shtrenjtë se po ta bënte buxheti i shtetit.

Pyetja më normale është, a e keni parë ndonjëherë ju, zonja zëvendësministre, VKM-në nr. 634, të 2014-ës?

Albana Shkurta – Jo, nuk e kam parë.

Florion Mima – Nuk e ke parë.

Kur ka kaluar ajo VKM, opozita, e cila është po e njëjta me atë të 2014-ës, ka thënë: “Mos e bëni me vendim qeverie këtë punë, sepse kjo punë mban erë. Jo, do ta bëjmë, se kështu e bën gjithë bota. Ju nuk merrni vesh.”

Praktikisht, ju po shfuqizoni 634-ën, por jo në ajër, sepse ka disa efekte që shqiptarëve duhet t'u themi, sepse mund të duhet 30 vjet për të rregulluar këtë që ka ndodhur nga 2014-a deri më sot, disa të tjera mund të jenë më shumë se 30 vjet. Po jua shpjegoj pse?

Jua kanë thënë vartësit se çfarë thonë direktivat europiane për standardet europiane të kontabilitetit për sektorin publik dhe standardet ndërkombëtare ESA 95 dhe IPSAS për pagesat që kanë rrezik dhe risk për të ardhmen? Si mund t'ia thuash këtij komisioni këtu? Ministër, ne kemi një rregull fiskal, nuk duhet të kalohet 5% i të ardhurave. Atë rregullin merre dhe bëje çaj. Si është impaktuar borxhi publik? Si është ndikuar nga këto PPP-të? Dikush thotë 2,2, dikush 2,7, diku lexova që është 3 miliardë euro vlera totale e koncesioneve në rrugë, kontrata të lidhura, më e frikshme nuk ka ardhur ende. Sot që ne jemi duke diskutuar shfuqizimin e kësaj, ju po sot keni sjellë krijimin e Korporatës Shqiptare të Investimeve. A keni parë ju këtë projekt? E keni parë.

Kjo korporatë që do të administrojë gjithë pasurinë e popullit shqiptar, jo të shtetit, por të popullit, do të bëjë prokurime jashtë rregullave të prokurimit publik, do të marrë hua jashtë rregullave të huamarrjes, do t'ia shesë dhe do t'ua tjetërsojë pronat shqiptarëve pa rregulla dhe sigurisht do të hyjë në marrëveshje PPP-je. Pra, këtë e shfuqizoni sa për t'iu

hedhur hi syve shqiptarëve, FMN-së dhe kujtdo tjetër që ju kritikon dhe nga ana tjetër keni nxjerrë edhe një shifër. Nevojat e Shqipërisë për PPP në infrastrukturë kryesisht janë 13,7 miliardë euro, 110% e GDP-së së këtij vendi.

Dakord vendosët ta rishikonit dhe të vinit dorë te ky ligj, po përse vetëm për rrugët? Po incenerimi nuk duhet të përfshihet këtu? Po mjekësia nuk duhet të përfshihet këtu?

Zonja Zëvendësministre, këto janë shifrat që unë doja t'ju përmendja dhe mund të jem edhe i revoltuar, sepse bëhet fjalë për miliarda e miliarda euro.

Rakip Suli - Zoti Mima, unë mendoj se sado që ta ngrini tonin, nuk e mohoni dot realitetin, sado që të mundoheni të përbaltni diçka reale, prapë nuk mundeni dot. Kur ishit ju në pushtet, a e dini sa iu ka kushtuar shqiptarëve rruga e Elbasanit, që ende sot është e papërfundur si rrugë e mbetur rrugëve? Janë 400 milionë euro të dala nga portofoli i shqiptarëve dhe nga arka e shtetit. Sot ti paragjykon Rrugën e Arbrit, që deri në momentin që ne flasim, është bërë 30% e punës dhe në vitin 2021 ajo merr jetë si rrugë, por për atë rrugë nuk ka dalë ende asnjë lek nga arka e shtetit, pra nga taksat e shqiptarëve. Deri sot në Rrugën e Arbrit nga arka e shtetit nuk është hedhur asnjë qindarkë, por është bërë me paratë e kompanisë private. Tani më jep llogari ti për 400 milionë eurot e rrugës së Elbasanit, e mbetur rrugëve, që nuk është as 15 kilometër!

Këto janë shifra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi- Ju lutem, lëreni të mbarojë!

Rakip Suli- Së dyti, prandaj, zoti Mima, ka një komision, ku ti ke të drejtë të propozosh dhe, nëse na bind me propozimet tuaja, ne jemi gati të pranojmë kërkesat tuaja. Ti ke qenë edhe vetë në atë dikaster si ministër. Ju lutem, mendoj se shqiptarët kanë njëmijë halle dhe probleme dhe duhet të dalim pak mbi politikën kur flasim për interesat e popullit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk merrem me fjalë rrugësh, unë merrem me realitetin, miku im. Ka ikur koha e fjalëve të rrugëve dhe shqiptarët e kanë kuptuar qartë këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Secili mban përgjegjësi individuale.

Së dyti, në 27 vjet jam i vetmi deputet në këtë parlament që u ngrit një akuzë në Gjykatë Kushtetuese. Doni ose nuk doni, po afrohet reforma dhe ju dhe kush ka abuzuar do ta gjejë vendin. Sado mundoheni për të nxjerrë njerëz në rrugë, reforma në drejtësi po merr formë për të kryqëzuar secilin që ka abuzuar në 25 vjet, nuk e ndal dot asnjëri më.

Faleminderit!

Niko Peleshi- Po, zoti Hasa.

Endri Hasa - Po e filloj nga kjo e fundit, meqë e përmendi Rakipi rrugën Tiranë-Elbasan. Ajo rrugë që mbeti rrugëve, siç thoni ju, u bë 80% për 18 muaj. Që nga ai moment filloi të vidhet hapur, sepse do të merrte milionat e milionat Edmond Bega me nënkontraktme, prandaj ajo rrugë nuk ka mbaruar ende sot. Kanë dalë ministra e ministra dhe do të vijë edhe kjo e reja dhe do të kërkojë ndonjë shtyrje afati. Erdhi Damian Gjikhuri para dy vjetësh dhe tha se do të mbaronte ajo rrugë në fund të dhjetorit, ose do të mbaronte para zgjedhjeve të vitit 2017. Çfarë bëhet aty? Vetëm vidhet. Shpikën edhe tunele panoramike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk kam informacion? Po atë rrugë e vuajnë elbasanllinjtë. E vuajnë se doni të vidhni ju të gjithë, sepse ju keni sjellë ligje, keni sjellë koncesione me ligj. Çfarë është kjo? Kjo është thjesht një fasadë. Vjen ai këtu dhe mban hartime. Për çfarë mbani hartime? Ju miratoni ligje, por nuk keni nevojë për ligj koncesionesh. Për PPP-të e famshme keni miratuar ligje, ju keni ardhur me ligj për Teatrin, për aeroportin e Vlorës e sa të doni ligje të tjera. Pse përmendni datën 1 korrik? Doni të prisni 30 qershorin, sepse keni zgjedhje? Sepse janë klientët e radhës që do të marrin lekët për zgjedhjet? Çfarë janë këto? Bëhen ndryshime dhe thuhet që ndryshimet janë parimore, por, në fakt, ndryshimet i bëtë, sepse hëngrët dru nga ndërkombëtarët. Pra, krijoni fasadën për ta fshehur dhe nga ana tjetër jepni autorizime me ligje pa ligj në të gjitha drejtimitet e tjera.

Niko Peleshi- Ju lutem, të qëndrojmë te rendi i ditës!

Nëse ju vazhdoni kështu, mund të shtyhet edhe data 1 korrik.

Endri Hasa- Propozimi ynë është ndryshimet vlejné për çdo koncesion dhe, përveç kësaj, hyjnë në fuqi menjëherë. Pse vazhdojnë e marrin lekë nga paratë e shqiptarëve inceneratorët? Çfarë të mire publike po sjellin? Kjo duhet të analizohet dhe të hetohet.

Niko Peleshi - A keni diskutim për projektligjin?

Endri Hasa- Unë për projektligjin po flas, duhen anuluar të gjitha PPP-të. Të gjitha do të jenë subjekt i ligjit antimafia dhe do të diskutohen një për një. Dhe të gjithë do të mbajnë përgjegjësi për çdo qindarkë që kanë vjedhur, sepse ia morët frymën këtij populli.

Po, do t'i marrim mandatet, pse ty do të pyesim?

Rakip Suli - Zoti kryetar, meqenëse ne sot e kemi ligjin në parim, e votojmë në parim, pastaj, kur të vijë nen për nen, secili ka të drejtë të japë mendime, pastaj e hedhim në votim. Po që se do të futemi te pjesa e politikës, do të rrimë 4 orë këtu dhe gjithsecili do të

mbrojtje mendimet e tij, sepse ashtu e mendon dhe ashtu e kujton. Tani, meqenëse ne kemi ardhur për projektligjin, e diskutojmë sot dhe e hedhim në votim në parim.

Niko Peleshi - A ka diskutime të tjera?

Agron Shehaj - Meqenëse zoti Mima tha se koncesionet përpara nuk janë paguar nga buxheti i shtetit, unë i shikoj ato edhe më të rrezikshme, sepse ato kanë marrë paratë e qytetarëve dhe të biznesit. T'i marrim me radhë: kontrolli i automjeteve, skaneri e të tjera, ato nuk i paguan biznesi që ka koncesionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E njëjta gjë është, madje këto i paguajnë direkt qytetarët dhe biznesi dhe ka një kosto shtesë.

Niko Peleshi - Zoti Luka

Lorenc Luka - Dëgjova kolegët që flasin për etikë dhe kërkojnë etikë, por, për hir të së vërtetës, ata që e kërkojnë, e prishin të parët.

Marr shkas nga propozimet e kolegëve karshi që kërkonin ta shtynin në kohë, sepse edhe ata vetë e kuptuan se përfaqësuesja e ministrisë ishte e papërgatitur dhe nuk ishte aspak serioze në përgjigjet që po jepte.

Kolegë, edhe mosrespektimi nga përfaqësuesit e ministrisë është shkelje etike, është mosvlerësim për të gjithë ne që jemi këtu. Nëse ju e pranoni këtë mos vlerësim dhe këtë fyerje, unë do të protestoj, sepse ne bëme pyetjet me dëshirën e mirë për të përmirësuar, por, fatkeqësisht, nuk morëm përgjigje. Ky është serioziteti i përfaqësuesve të kësaj qeverie. Është e turpshme kështu.

Niko Peleshi – Një sqarim për zotin Panariti: kam këtu raportin e mbledhjes së komisionit, ku është marrë në shqyrtim propozimi për të cilin folët. Meqenëse ishte një projektligj i miratuar në qeveri dhe i ardhur këtu për diskutim (bëhet fjalë për projektligjin që po diskutojmë sot), komisioni me shumicë votash gjykoi që të mos e miratojë amendamentin që ju keni prezantuar.

Nuk kanë qenë të pranishëm kolegët e opozitës...

Edmond Panariti - Nuk janë njoftuar!

Zoti kryetar, ka një shkelje procedurale. Ka kaluar në mungesën tonë. Ne nuk jemi ftuar për të bërë mbrojtjen dhe argumentimin...

Niko Peleshi – Prezenca këtu nuk është e detyrueshme!

Edmond Panariti -Duheshim njoftuar!

Unë bëra një konsultim me grupin parlamentar për të bërë verifikime, pra nuk është krijuar mundësia për të bërë mbrojtjen e propozimeve tona përballë këtij komisioni. Kështu

që në mënyrë unilaterale është kaluar pa na dhënë mundësinë për dhënë argumente dhe kundërargumente.

Niko Peleshi – Meqenëse jemi në këtë diskutim, besoj se kjo është e ezauruar, sepse ju keni mundësi qoftë në diskutimin në parim, qoftë në atë nen për nen, t'i integroni propozimet tuaja në këtë projektligj në qoftë se ato do të votohen në komision dhe në seancën parlamentare.

Edmond Panariti -Dakord, zoti kryetar!

Do t'ju kërkoja që kur të vijë puna te diskutimi nen për nen, të thirren edhe propozuesit e amendimeve për të dhënë edhe ata opinionin e tyre, argumentet dhe kundërargumentet.

Niko Peleshi – Ju jeni vet anëtar i atij grupi parlamentar, porm pa dyshim, në këtë komision mund të ftohen edhe të tjerë që ta pasurojmë diskutimin nen për nen të këtij projektligji.

Zoti Shehaj, fjala për ju.

Agron Shehaj – Faleminderit!

Mendoj se ndryshimet në këtë ligj nuk kanë absolutisht asnjë efekt, sepse nëse bëjmë ligje që të parandalojmë abuzimet apo vjedhjet, ky ndryshim nuk e arrin këtë efekt në këtë drejtim. Ne kemi probleme shumë më të mëdha.

Do të doja të flisnim për faktet, për mënyrën se si po vidhet nëpërmjet koncesioneve, sipas mendimit tim. I gjithë projekti i famshëm 1 miliard, por që në fakt është shumë më shumë se aq, është thjesht një skemë për të vjedhur në mënyrë të jashtëzakonshme. Pse e them këtë? Kuptohet, ju keni të drejtë kur thoni se duhet të flasim me prova, por ne nuk mund t'i kapim ministrat me çantat me para, ne nuk jemi hetues, as prokurorë.

Kam këtu parasysh rastin e fundit, koncesionin Orikum-Dukat, 70 milionë euro për rindërtimin e një rruge ekzistuese që nuk ka absolutisht asnjë nevojë, nuk është prioritet. Rugën e kemi bërë të gjithë dhe mendoj se në atë zonë ka rrugë shumë më të këqija, me nevoja shumë më të mëdha se kjo. Shuma e vënë në dispozicion prej 70 milionë eurosh për 16 kilometra na bën të mendojmë se aty po vidhet në mënyrë gjigande. Kostoja e kësaj rruge nuk mund të shkojë më shumë se 1 milion për kilometër, dhe kostoja maksimale e saj, se po flasim për të njëjtën rrugë dhe jo për një rrugë me 4 korsi, as për një autostradë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ju lutem, diskutoni për projektligjin!

Agron Shehaj – Unë po flas për gjëra konkrete, nuk po flas...

Niko Peleshi – Kjo është mbledhje komisioni. Qëndro brenda diskutimit teknik për këtë projektligj. Në qoftë se ju mendoni se ky projektligj është kot, thoni se jeni kundër në parim.

Agron Shehaj – Më lejoni ta argumentoj!

Një rrugë që maksimumi do të kushtonte 16 mijë euro, se nuk po flasim për një autostradë, nuk po flasim për tunele, por po flasim për rikonstruksionin e një rruge të thjeshtë ekzistuese, nëse kontrata firmoset për 70 milionë euro, do të thotë se 54 milionë euro, në gjykimin tim, janë vjedhje që i bëhet njërit nga popujve më të varfër në Europë.

Fakti që është fituar me një fond limit prej 99,96% na bën gjithashtu të dyshojmë se kjo është vjedhje. Kompania tjetër, që ka bërë ofertën, e ka bërë këtë me një vlerë mbi fondin limit, që praktikisht është si të vetëskualifikohesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë më pyetët, merrni statistikën e vendeve të tjera Perëndimore dhe do të shikoni në përqindje sa është ulja nga fondi limit me të cilën jepen...

Niko Peleshi – Më falni, po çfarë lidhje ka kjo që po thoni me këtë projektligj?

Jeni dakord në parim me këtë projektligj, apo jo? Ju mendoni se formula e propozimit të pakërkuar, apo gjithë procedura e prokurimit publik është e paduhura dhe lë vend për abuzime, pra jepni mendimin tuaj për këtë projektligj. Në qoftë se ju nuk jeni dakord...

Agron Shehaj – Fakti që ju nuk kapni lidhjen midis asaj që unë po them dhe këtij projektligji më bën të dyshoj!

Niko Peleshi – Po diskutoni për inteligjencën time?

Agron Shehaj – Nuk po flas për atë. Më lejoni të mbaroj!

Më shumë për vullnetin sesa për inteligjencën tuaj, se jam i bindur që ju e kuptoni vjedhjen dhe, tjetër gjë, që nuk doni të flisni rreth saj.

Niko Peleshi – Nuk është puna se nuk dua, jemi në komision dhe kam për detyrë t'ju kujtoj se në ç'fazë të procedurës jemi.

Agron Shehaj – Është e vështirë të justifikoni 40 milionë euro.

Niko Peleshi – As nuk kam ndërmend t'i justifikoj, sepse nuk është as detyra ime, e as juaja!

Agron Shehaj – Po aq e vështirë është të justifikosh 50 milionë euro për një nga vendet më të varfra në Europë, për një rrugë që nuk ka nevojë për t'u rindërtuar, ku i vetmi synim është vjedhja, ashtu siç ndodhi me koncesionin e Rrugës së Kombit, ku dhatë një koncesion prej 400 milionë eurosh, pra po u merrni nga xhepi kuksianëve 400 milionë euro.

Niko Peleshi – Të lutem, se ky është diskutim pa fund! Edhe deputetët e maxhorancës mund të fillojnë diskutime për Rrugën e Kombit, ku u vodhën 200-300 milionë e të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, përmbli dhe diskutimin!

(Diskutim pa mikrofon)

Agron Shehaj – Unë po flas me fakte. Nuk e di çfarë do të bëhet! Gara ka përfunduar, koncesioni po jepet 70 milionë euro për 16 kilometra. Ju e dinit, a ju bën përshtypje?

Niko Peleshi – A ke ndonjë propozim për komisionin se çfarë mund të bëjmë për këtë procedurë?

Agron Shehaj – Propozimi është të përjashtoni kompanitë offshore.

Niko Peleshi – Dakord, do ta diskutojmë nen për nen, nëse mund të shtohet një nen për kompanitë offshore, apo jo.

Agron Shehaj – Të përjashtoni mundësinë që kompanitë që fitojnë tenderat të transferojnë aksionet e kompanive që kanë fituar tenderin, për sa kohë zgjat koncesioni.

Niko Peleshi – Formuloje si nen dhe le ta diskutojmë...

Agron Shehaj – Propozime ka sa të duash, por në momentin që mungon vullneti politik...

(Diskutim pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ka diskutime të tjera?

Mund të them edhe unë dy fjalë? Nuk dua ta bëj politik diskutimin, por, për hir të së vërtetës, ky ka qenë problemi ynë, që jemi munduar t'i bëjmë vet të gjitha, politikanin, qeveritarin, prokurorin, hetuesin, gjyqtarin dhe në fund fare salla e parlamentit përfundon në teatër, se nuk mund t'i bëjmë dot të gjitha.

Për këtë arsye jemi të gjithë së bashku opozitë dhe maxhorancë duke i ndarë proceset dhe duke krijuar sisteme të pavarura të besueshme. Reforma në drejtësi synon të na heqë ne politikanëve, të paktën pjesën e prokurorit, gjyqtarit e të tjera. Deri më sot jemi legjitimuar, edhe ju këtë thatë, në parim nuk jam kundër legjitimitetit që i jepni vetes tuaj si prokuror apo gjyqtar, sepse kemi ende një sistem drejtësie të pabesueshëm. Ne duhet të fillojmë të shkëputemi tashmë nga kjo pjesë. Secili mund të ketë dyshimet e veta për një procedurë, mund të bëjë me mend aritmetikën 76 minus 16 dhe t'i rezultojë një vjedhje, por nuk duhet të marrim përsipër të bëjmë gjykimin këtu. Ne duhet të bëjmë ligje të mira.

Na ka ardhur një propozim për një projektligj me disa ndryshime. Për çfarë bëhet fjalë? Nuk është ashtu siç thatë ju, që ka ardhur një propozim si të shmangim vjedhjet. Procesi i ligjvënies është një proces dinamik dhe, pa dyshim, procedura e partneritetit publik privat dhe e koncesioneve ka risqe, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën, në Gjermani, në Francë, në Amerikë. Kjo nuk do të thotë se partneriteti publik privat duhet anatemuar dhe duhet të japim këtë konotacion negativ, që i ka dhënë për hir të së vërtetës lufta juaj opozitare, sepse nuk është kështu, por është një formulë që mobilizon energji të sektorit privat në bashkëpunim me sektorin publik në të gjithë vendin, edhe në vendet e zhvilluara...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Më falni, ta mbaroj! Nuk fola për shifra, përkundrazi, ju thashë që për dyshime...

Agron Shehaj – Do të flasim për gjëra konkrete, jo në ajër! 400 milionë euro koncesioni i Rrugës së Kombit...

Niko Peleshi – Konkretisht po ju flas.

Çdo qytetar, jo vetëm deputet, dyshimet konkrete ka të drejtë t'i thotë me zë të lartë dhe t'i adresojë në vendin e duhur. Këtu nuk ju ndihmojmë dot me këto ekuacionet apo shprehjet aritmetike që ju keni në mendje. Ato ju vlejnë vetëm juve për të dyshuar dhe pastaj mund t'i adresoni ku të doni, mediatikisht, në seancën parlamentare e të tjera.

Në qoftë se në këtë komision, meqë është takimi i parë, do të arrijmë ta ndajmë diskutimin tekniko-politik nga diskutimi puro-politik, do të thotë se edhe ne po evoluojmë si të gjitha sistemet e tjera që duhet të evoluojnë në këtë shoqëri, se jemi lodhur të gjithë bashkë dhe nuk kemi arritur gjë politikisht...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj fjalën.

Agron Shehaj – Rrezikojmë vërtet të bëhemi qesharakë! Ju sapo dolët zbuluar me një vjedhje prej 20 milionë eurosh, nuk janë fjalët e mia...

Niko Peleshi – Të lutem, mos ma ndërprisni fjalën! Mos më flisni për vjedhje...

Agron Shehaj – Nuk mund të na bëni moralin...

Kjo nuk është politikë, more zotëri!

Përveç faktit që unë jam këtu si politikan, dhe politikanët politikë bëjnë, se nuk jam teknik, ata janë jashtë salle...

Niko Peleshi – Nuk të thashë teknik, por tekniko-politik, që do të thotë...

Sigurisht, ju keni rreshtimin tuaj politik dhe me atë frymë do të diskutoni, por jo të arrijmë të marrim edhe funksionet e prokurorisë dhe gjykatave, se nuk kemi shpatulla t'i mbajmë! Jemi bërë të gjithë qesharakë në vite me këtë histori dhe, në fund fare, koha na ka

treguar që nuk fitojmë gjë. Ju jeni deputet i ri sikur unë, por ata që kanë më shumë eksperiencë këtë na thonë: “Nuk kemi fituar gjë në opinion”. Ti flet për vjedhje, ndërkohë deputetët e tjerë të maxhorancës rreshtojnë gjithë ato akuza, disa të konfirmuara, e disa thjesht dyshime, dhe në fund fare, qytetarët para televizorit thonë: “Këta qenkan të gjithë hajdutë”, këtë fitojmë, asgjë më shumë.

Jemi të dy deputetë të rinj, unë ndoshta kam pak më shumë në politikë, por ka të tjerë këtu që mund ta thonë këtë me mend, që historia këtu ka arritur. Këtë gabim e kanë bërë edhe politikanë të vendeve shumë më të zhvilluara se ne, janë marrë me njëri-tjetrin dhe, në fund fare, ka lindur e kundërta e politikës. Pra, në qoftë se duam të ruajmë veten, që të kemi fytyrë të dalim para popullit që përfaqësojmë, mirë është të jemi më etikë dhe të mos i tejkalojmë kufijtë tanë.

Nuk besoj se biem në kundërshtim që partneriteti publik privat nuk është formulë shqiptare, nuk është as formulë e botës së tretë, por vjen nga vendet e zhvilluara. Ndërkohë, jam absolutisht dakord me të gjithë ju, edhe me opozitën, që formulat e partneritetit publik privat mbartin me vete risqe të caktuara fiskale, buxhetore, risqe në zbatim dhe risqe në planifikim.

Sa u përket risqeve fiskale dhe buxhetore, meqenëse kam qenë pjesë e qeverisë, çështja e koncesioneve të partneritetit publik privat sa u përket risqeve fiskale dhe buxhetore, deri më sot nuk ka qenë e pakontrolluar apo e padisiplinuar. Pse? Zoti Mima mund të më kundërshtojë, por ne kemi një kufizim të miratuar në parlament për fondin nga buxheti i shtetit të shërbimit të koncesioneve dhe partneriteteve, i cili ka si tavan 5% të totalit të të ardhurave. Me sa më kujtohet, ky tavan, që i bie rreth 190 milionë euro, na është kërkuar dhe e kemi diskutuar edhe me FMN-në, e cila nuk e ka lejuar qeverinë dhe nuk lejon asnjë qeveri që me partneritetet publike private apo me koncesionet ku angazhohet, të tejkalohjë apo të dalë jashtë takatit të vetë financiar buxhetor për të paguar këstet buxhetore, le ta themi kështu.

Gjithsesi, risku qëndron, sepse është risk i një procedure jo 100 % të konsoliduar edhe në vende më të zhvilluara. Duhet ta konsolidojmë këtë procedurë, ndaj kemi sjellë edhe një përmirësim ligji. Nëse nuk mjafton edhe ky përmirësim ligji, duhet të ndërtojmë mekanizma të kontrollit të zbatimit të këtij ligji, të cilat janë më efektive. Ka një përmirësim në këtë ligj, Ministrisë së Financave i jep një funksion më të fortë, mbase nuk mjafton, por le ta pasurojmë edhe ne me kontributet tona në diskutimin nën për ne, në qoftë se kemi mundësi.

Sa i përket riskut të zbatimit, ai qëndron. Përsëri pritet kontributi ynë se si mund ta minimizojmë këtë risk, sidomos për vepra të mëdha.

Risku i planifikimit, gjithashtu, është një risk, të cilin qeveria nuk e parashikon dot, pra, në qoftë se ne mirëpresim dhe hapim propozimet e pakërkua në të gjithë sektorët, kjo e vendos në vështirësi qeverinë për të planifikuar projektet e veta. Ndaj sot këtu po propozohet që të minimizohet dhe të tkurret hapësira e propozimit të pakërkua vetëm në disa sektorë.

Në mos gabo, jo për diversion politik, por edhe në qeverinë para vitit 2013, energjetika ka qenë pjesë e propozimeve të pakërkua. Janë lidhur, ne i kemi kritikuar, se me të vërtetë kanë qenë barrë mbi buxhetin dhe vazhdojnë të jenë, se në atë kohë nuk ishte ky rregullim buxhetor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke gabim! Kishte detyrimin për t'i blerë dhe ky detyrim për të blerë energjinë elektrike të prodhuar vazhdon edhe sot, për fat të keq, edhe kur nuk kemi nevojë, çka do të thotë se edhe kur ti je në momente eksportimi dhe kur çmimi energjisë elektrike bie shumë në bursë, je i detyruar të blesh nga hidrocentralet energji me çmim të fiksuar, i cili mund të jetë mbase dyfish më i lartë krahasuar me çmimin e tregut. Je i detyruar ta blesh duke rënduar mbi shpatullat e qytetarëve, sepse ke një kontratë.

Këtë që thashë, nuk e kam diskutim për të mallkuar të gjithë procedurën e partneritetit publik privat, jo. Edhe këto detyrime që rëndojnë mbi buxhetin e shtetit mund të jenë të domosdoshme, mund të mos ketë formulë tjetër përveç kësaj, për t'i bërë privatët të interesuar të investojnë, për shembull, në hidrocentrale. Po bëj tani edhe avokatin e palës tjetër. Nuk është një formulë e re, nuk është shpikje shqiptare, nuk është shpikje e kësaj qeverie, në këtë projektligj synohet vetëm disiplinimi, kufizimi dhe përmirësimi i këtij projektligji për të shmangur risqet që unë përmenda e që në syrin tim janë fiskale, buxhetore, planifikimi dhe zbatimi.

Për sa i përket shtyrjes së afatit të rrugëve, s'mund të lë pa e thënë që e vërteta është që disa projekte rrugësh, siç është rruga Qukës-Qafë Plloçë, apo rruga Tiranë-Elbasan vërtet ishin rrugë të filluara, por nga ana teknike projektet kanë qenë copë-copë dhe na është dashur t'i ribëjmë, të paktën rrugën Qukës-Qafë Plloçë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, absolutisht! Nuk i bën niveli politik, por ai...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk akuzova deputetët për projektin teknik...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se është një projekt i pazbatueshëm, për t'i rënë shkurt themi “pa projekt”, dhe, në qoftë se projekti është copë-copë, do të duhet ta ribësh nga e para.

Ky ishte opinionimi im. Shumë faleminderit për kontributin!

Ka ndonjë diskutim tjetër?

Propozoj që projektligjin ta kalojmë sot në parim dhe diskutimin nen për nen të lëmë një datë tjetër. Kush është dakord në parim për miratimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim.

Do të njoftojmë për ditën dhe orën kur do të diskutohet nen për nen ky projektligj. Ndërkohë, i kam kërkuar sekretares të shpërndajë informacionin apo sugjerimin me shkrim që ka ardhur nga një organizatë, Eko Albania, të cilin do ta keni të gjithë në *e-mailin* tuaj.

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA